



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 267/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Gjakovë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Gjakovë, për shkak të dëmtimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Gjakovë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 17.10.2013, nga subjekti politik AKR dega në Gjakovë, në të cilën theksohet se me dt 15.10.2013 në disa pjesë të qytetit hapsirat e marketingut për Kryetar Komune në Gjakovë, janë dëmtuar nga aktivist të subjektit politik AAK-së dhe se nga kjo pretendojnë se me këtë veprim ka shkelur nenin 33 pika a të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 3 pika a të Kodit të Mirësjelljes së Subjekteve Politike dhe nenit 3.6 për Rregullat Zgjedhore 13/2013, si dëshmi ka bashkangjitur disa fotografi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik AAK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 18.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 19.10.2013. Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AAK, në të cilën potencohet se ankesa në fjalë është e pabazë sepse dëmtimet e hapesirave të marketingut të Znj. Mimoza Kusari Lila në Gjakovë nuk është bërë nga ana e strukturave të subjektit politik AAK. mëtej në përgjigje të ankesës theksohet se këto akte mund të jenë bërë nga qytetarë apo individë të paidentifikuar dhe vlerësojnë se është e padrejtë që pa asnjë fakt t'i adresohet AAK-së kjo ankesë dhe me propozim që PZAP-i ta hudhë ankesën poshtë si të pabazë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, nga shkresat e lëndës konstatoi se pretendimet ankimore të subjektit politik AKR, nuk qendrojnë, sepse provat e bashkangjitura në ankesë si dëshmi lidhur me shkeljen e supozuar nuk janë të asaj natyre që do të ndikonin për të marrë ndonjë vendim ndryshe, ngase nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk mund të

identifikohet se subjekti politik AAK është përgjegjës për veprimet e tilla siç pretendohet në ankesë, prandaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 .1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 267/2013 më datën 25.10.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*